

Nr. _____ prot.

Vorë, më _____.____.2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbime dhe riparime (servise) për mjetet e Administratës dhe Mzsh”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 50112000-3 - Shërbime riparimi dhe mirëmbajtje makinash

VLERA E FONDIT LIMIT: 5 500 000 (pesë milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Vore ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 10

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të jenë të pajisur me Licencë të kategorisë VII.3.B.1

(a,b,c,ç) “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në përputhje me kërkesat e:

- (a) ligjit nr. 9573, date 03.07.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to” dhe
- (b) VKM nr. 107, datë 10.02.2016, “Për një shtesë në VKM nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur në bazë të pikës 2, neni 77, Kreu XII të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pikës 4/a, neni 41, Kreu V të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), Ligjit nr. 9573, date 03.07.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, VKM nr. 107, datë 10.02.2016, “Për një shtesë në VKM nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” si dhe në Udhezimin nr. 1546, datë 29.03.2016, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022,2023,2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në pikën 3, neni 77 e LPP, pikën 4, neni 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) si dhe neni 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara 2021,2022,2023 për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të njohur me gjendjen ekonomike të operatorit ekonomik të paktën për tre vitet e fundit, për të pasë siguri që operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 4 e neni 55 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e

Hapur të Thjeshtuar, perkatesisht; Pika 4 :*Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave*; Autoriteti Kontraktor duke u bazuar ne eksperiencen e suksesshme te procedurave te zhvilluara me pare, rëndësinë e objektit të prokurimit për mbarëvajtjen e punës si dhe hyrjes në marrëdhënie kontraktuale me operatorë ekonomikë seriozë në treg gjykon se është e pershtatshme vendosja e kriterit te marzheve maksimale të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare*; si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin Mbi të Ardhurat" i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2022, 2023 dhe 2024**, të çertifikuara nga autoritetet përkatese (Dega e Tatim Taksave) ku bilancet e dy viteveve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit nr. 10091 datë 5.3.2009 "*Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar*", i ndryshuar

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "*Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, neni 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 4/b, neni 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet. Me anë të këtij kriteri vërtetohet se operatorët ekonomikë kanë përvojë të mëparshme për procedura të ngjashme me objektin që prokurohet si dhe kanë përmbushur me sukses kontratën për të cilën janë shpallur fitues. Kjo tregon se operatori ekonomik është vazhdimisht i angazhuar në treg me kontrata shërbimi, çka rrit besueshmërinë te Autoriteti Kontraktor se në rast shpallje fitues, ekzekutimi i kontratës do të jetë në përputhje me përcaktimet e DST, dispozitat e kontratës dhe planit të zbatimit të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë ambient/servis për realizimin e shërbimit:

a. Operatori ekonomik duhet të ketë minimumi një ambient pune (servis/oficinë) të përshtatshme për kryerjen e shërbimeve për të gjitha llojet e mjeteve sipas specifikimeve teknike objekt në funksion të realizimit të kontratës, të përshtatshëm për ushtrim aktiviteti sipas objektit të prokurimit. Për këtë, operatori ekonomik ofertues, duhet të paraqesë dokumentacion që vërteton pronësinë/huapërdorjen/qiramarrjen si më poshtë:

a.1.1 Dokumentacion që vërteton pronësinë:

- Certifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose
- kontrata e shitblerjes; ose
- kontrata e dhurimit; ose
- çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

a.1.2 Dokumentacion që vërteton huapërdorjen:

- Kontratë huapërdorje.

a.1.3 Dokumentacion që vërteton marrjen me qira:

- Kontratë qiraje..

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur në bazë të nenit 77, Kreu XII të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pikës 6, nenit 41, Kreu V të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Shërbimet e mirëmbajtjes dhe të riparimit të automjeteve në rast defekti duhet të kryhen në ambiente të përshtatshme, servis ose oficinë i pajisur me të gjitha mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës. Në mënyrë që të vërtetohet që operatorët ekonomikë disponojnë hapësirën e nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë së tyre gjykojmë se është e nevojshme dokumentimi i këtij fakti përmes paraqitjes së një dokumenti i cili vërteton pronësinë, huapërdorjen, qiramarrjen referuar dispozitave përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 15, pika 3/b dhe nenit 41, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Specifikimet teknike për shërbimet objekt prokurimi sipas shkresës Nr.4441 Prot, date 22.09.2025 nga Drejtoria e Mirëmbajtjes dhe Mbikqyrjes së Infrastrukturës. Specifikimet teknike, për shërbimin objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që e vlerëson shërbimin si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Ne specifikimet teknike që janë hedhur në dokumentet teknike të tenderit nuk është përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

VLERA LIMIT E KONTRATËS,

Vlera e fondit limit të kontratës nga grupi i punës i ngarkuar për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, është hartuar bazuar në mesataren e studimit të tregut, në mbështetj dhe zbatim të pikës 1, shkronja b) të nenit 76, të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar ku parashikohet se: b) studimi i tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim. Praktikë e cila është e dokumentuar me dokumentacion shkresor në dosjen e prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT